

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Avdi Dinaj, kryetar, Emine Mustafa dhe Nebojsa Boriçiq, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Qefsere Berisha, procesmbajtëse, në çështjen penale të dënuarve P. K., I. B. dhe E. T., për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psiko trope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 275 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit F. Sh., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti i Përgjithshëm Prizren P.nr.1062/2014 datë 18.09.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1608/2015 datë 23.02.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 28.04.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit P. K., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore-Departamenti i Përgjithshëm Prizren P.nr.1062/2014 datë 18.09.2015, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1608/2015 datë 23.02.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti i Përgjithshëm Prizren P.nr.1062/2014 datë 18.09.2015, të dënuarit P. K., I. B. dhe E. T., janë shpallur fajtor për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psiko

trope ose analoge në bashkëkryerje nga neni 275 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe për këtë veprë janë gjykuar secili veç e veç me dënime me gjobë në lartësi prej 200 €, ashtu që të njëjtën i dënuari P. K. është i detyruar që të paguajë në këste dhe atë këstin e parë prej 100 €, ndërsa të dënuarit I. B. dhe E. T. në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në rast se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, gjykata dënimet e të dënuarve do t'i zëvendësoj me dënime me burgim duke llogaritur 20 €, për 1 ditë burgimi, respektivisht me 10 ditë burgim. I ka detyruar që të paguajnë në emër të paushallit gjyqësor në mënyrë solidare shumën prej 30 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Ky aktgjykim është ndryshuar me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1608/2015 datë 23.02.2016, si në vijim:

“me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Themelore në Prizren, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren P.nr.1062/2014 datë 18.09.2015, ashtu që kolegji i Gjykatës së Apelit , të akuzuarve P. K., I. B. dhe E. T., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje posedimi i paautorizuar i narkotikëve-substancave psiko trope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, ju shqipton dënimin me gjobë secilit në shumën prej nga 500 €, të cilin dënim të akuzuarit obligohen që ta paguajnë në afat prej 15 ditëve, në të kundërtën dënimin me gjobë secilit të akuzuar i shëndrohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 25 ditëve duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 €”.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit P. K., F. Sh. avokat nga Prizreni, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, dhe shkeljes së ligjit penal me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen ashtu që të dënuarit t'i shqiptohet një dënim bazuar në ligj.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes në kuptim me dispozitën e nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve nga kërkesa ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Në kërkesë, mbrojtësi i të dënuarit edhe pse pretendon se aktgjykimet janë përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga referati i kërkesës rezulton se kërkesa është paraqitur vetëm për shkak të shkeljes së ligjit penal respektivisht dispozitës së nenit 73 dhe 74 të KPK, e cila shkelje konsiston në atë se dënimi i shqiptuar të dënuarit P. K. është jo proporcional me pasojën e shkaktuar sepse në rastin konkret mungon pasoja e dëmshme e veprës penale, pastaj nuk është vlerësuar pranimi i fajësisë nga i dënuari dhe në këto rrethana është dashur të aplikohen dispozitat për zbutjen e dënimit. Në kërkesë theksohet se meqë edhe gjykata e shkallës së dytë nuk ka aplikuar dispozitat për zbutjen edhe gjykata e i shkallës së dytë ka bërë shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se nuk është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit për këto arsye:

Siç rezulton nga shkresat e çështjes i dënuari P. K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psiko trope ose analoge nga neni 275 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe për këtë vepër i është caktuar dënimi me gjobë në shumë prej 200 €. Gjykata e shkallës së dytë, ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë përkitazi me vendimin për dënimin dhe për këtë vepër i ka përcaktuar dënimin me gjobë në shumë prej 500 €.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat e parapara nga dispozita e nenit 73 të KPK, ashtu që si rrethana lehtësuese ka marrë parasysh pranimin e fajësisë se për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, se është i moshës së re dhe është pënduar për veprën e kryer penale si dhe premtimin e dhënë se në të ardhmen nuk do të përsërisë ndonjë vepër tjetër penale. Gjykata e shkallës së dytë, me rastin e matjes së dënimit si rrethanë rënduese ka vlerësuar shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe në prani të këtyre rrethanave të dënuarit i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit duke pritur se me një dënim të tillë mund të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me ligj.

Dispozita e nenit 73 të KPK, parashikon rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit ashtu që konform par.1 të kësaj dispozite janë paraparë në mënyrë të përgjithësuar se cilat rrethana gjykata do t'i merr parasysh gjatë matjes së dënimit dhe me atë rast i cek rrethanat më tipike lehtësuese dhe rënduese , duke ia lënë mundësinë gjykatës që në çdo rast konkret të marrë parasysh edhe rrethanat tjera, të cilat ndikojnë që të shqiptoj dënimin më të rreptë apo më të butë. Në mesin e rrethanave që parashihen me par.1 gjenden rrethanat objektive që i referohen veprës penale dhe ato subjektive që i referohen kryerësit. Rrethanat lehtësuese dhe rënduese janë ato rrethana të cilat janë prezent me rastin e kryerjes së veprës penale por nuk janë element të saj, nuk hynë në figurën e saj.

Në rastin konkret, duke pasur parasysh faktin se për veprën penale për të cilën i dënuari është shpallur fajtor është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 1 (një) vit, pra në këtë rast nuk ka dyshim se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë duke ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me vendimin mbi sanksionin penal, përmes institutit të matjes së dënimit në kuptim të dispozitave të lartcekur ka bërë individualizimin e dënimit dhe ka shqiptuar dënimin brenda kufijve të përcaktuar me ligj për këtë vepër penale, për çfarë gjykata e shkallës së dytë lidhur me ashpërsimin e dënimit ka dhënë arsye në faqen 3, të aktgjykimit të cilat si të drejta dhe të ligjshme i pranon edhe kjo gjykatë.

Nga arsyet e lartcekura, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është refuzuar si e pabazuar dhe në pajtim me dispozitën e nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

PML.nr.93/2016 datë 28.04.2016

Procesmbajtëse,
Qefsere Berisha

Kryetar i kolegjit,
Avdi Dinaj